



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

Nëntor 2017

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

**Nëntor 2017**

© Ministria e Financave, 2017

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

E-mail: [vivi.besho@financa.gov.al](mailto:vivi.besho@financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin nëntor 2017 arriti në 102.59 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin nëntor 2017 ishte 1.7 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin nëntor 2017 ishte 114.01 lekë për dollarë dhe 133.49 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit nëntor 2017 shënuan kuotën 0.74 për qind për ato 12 –muajore; 0.61 për qind për depozitat 6-mujore; 0.26 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.87 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 6.00 për qind për huatë 12-mujore dhe 7.73 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në rreth 1,252,569 milionë lekë në muajin nëntor, duke shënuar një rritje prej rreth 1.5 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e tretë të 2017-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 37.6 milionë euro.
- *Situata Buxhetore për periudhën janar-nëntor 2017 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 10.5 miliardë lekë, që do të thotë se janë mbledhur rreth 8.6 miliardë lekë më shumë se planifikimi për këtë periudhë (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 19.1 miliardë lekë).*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-nëntor 2017, arritën në rreth 390.4 miliardë lekë ose afërsisht 99 % e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 400.9 miliardë lekë ose 97 % e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*

# Zhvillimet Ekonomike


## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin nëntor 2017 ishte +1.7%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +1.9%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin nëntor 2017 shënoi rënie prej 0.1 për qind krahasuar me muajin paraardhës, ndërsa në muajin tetor pati rritje prej 0.04 për qind. Gjithashtu përgjatë muajit shtator, indeksi ka shënuar rritje prej 0.4 për qind në krahasim me muajin paraardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin nëntor 2016 shënoi rënie rritje 0.1 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +3.7%, duke kontribuar me +1.39 pikë përqindje; “Transporti” me një rritje vjetore të çmimit prej +1.9%, duke kontribuar me +0.12 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.7%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm e shënoi kategoria: “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me një rënie vjetore të



çmimit prej -0.5%, duke ndikuar negativisht me -0.03 pikë ; e pasuar nga “Veshje dhe këpucë” me një rënie vjetore të çmimit prej -0.4%, duke ndikuar negativisht me -0.02 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.7%.

Ndryshimi mujor i indeksit është -0,1 %. Krahasuar me muajin Tetor 2017 ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupet “Argëtim dhe kulturë” me 1,5%, pasuar nga “Ushqime dhe pije joalkoolike me 0,8 %. Rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupet “Transporti” me 1,3%, pasuar nga “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Shëndeti” me 0,4 % secili.

**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2016</b>	1.5	0.2	0.3	0.3	0.7	1.2	1.9	2.0	1.8	1.5	1.9	2.2
<b>2017</b>	2.8	2.2	2.1	1.9	2.0	2.2	2.0	1.6	1.6	1.9	<b>1.7</b>	


Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin nëntor 2017, arriti në 133.49 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.12 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit nëntor, një euro u këmbye me 133.64 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin nëntor 2017 arriti në 114.01 lekë/dollarë duke shënuar rritje me 0.24 për qind kundrejt muajit tetor 2017. Në fund të muajit nëntor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 112.97 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin nëntor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 1.98 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 9.36 për qind. Nën çmimi i lekut kundrejt monedhës evropiane dhe asaj amerikane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.




Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.85 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit nëntor 2017, normat e interesit të depozitave me afat 12 mujor shënuan vlerën më të lartë prej 0.74 për qind, pasuar nga ato me afat 1 dhe 6-mujore që arritën përkatësisht kuotën 0.87 dhe 0.61 për qind. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 3 mujore arritën kuotën 0.26 për qind.

Normat e interesit të depozitave 12 dhe 3-mujore kanë shënuar rënie mujore prej përkatësisht 0.07 dhe 0.04 pikë përqindje. Ndërsa rritje mujore kanë shënuar normat e interesit të depozitave 6 dhe 1 mujore prej përkatësisht 0.07 dhe 0.10 pikë përqindje.

Fig. 3




Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë shënuar normat e interesit të depozitave me afat maturimi 6, 3 dhe 1-mujore me përkatësisht 0.13; 0.07 dhe 0.04 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 12 mujore kanë shënuar rritje prej 0.05 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12-mujore gjatë muajit nëntor 2017 arritën përkatësisht kuotën prej 7.73 dhe 6.00 për qind. Normat e interesit të huave 12-mujore kanë shënuar rënie mujore prej 0.65 për qind, ndësa normat e interesit të huave 6-mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.34 për qind. Ndërsa krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12-mujore kanë shënuar rënie prej 4.36 për qind dhe 0.26 për qind.

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot

Burimi: Banka e Shqipërisë



Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit nëntor 2017 arritën nivelin 2.54 për qind duke shënuar kështu rritje mujore prej 0.08 për qind dhe rritje vjetore prej 0.07 për qind.

## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e dytë të vitit 2017 shënoi rritje të mjeteve valutore, me rreth 37.7 milionë euro. Tremujori i tretë i 2017-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 132.9 milionë euro, dhe vlerësohet në rënie me bazë vjetore (rreth 10%). Deficiti tregtar ra me rreth 13%, në nivelin 374 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 103 milionë euro në rënie me 43 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Flukset e kapitalit, shumat e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto negativ prej rreth 238.9 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 3,015 milionë euro dhe janë zgjeruar me 12% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 133 milionë euro, rreth 10% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Tkurrja e deficitit korrent, këtë tremujor, u diktua nga zgjerimi i ndjeshëm në suficitin e llogarisë së shërbimeve. Ky zhvillim u mbështet nga flukset e larta hyrëse në “shërbime të tjera biznesi” si dhe në “shërbime udhëtimi”. Kompozicioni deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për tremujorin e parë 2017 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -753.8 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 380.2 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me 28.5 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 212.2 milionë euro.





## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit nëntor 2017, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 16,087 milionë lekë krahasuar me muajin nëntor të vitit 2016. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 8,237 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 6,570 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 3,639 milionë lekë të bankës qëndrore.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,252,569 milionë lekë në muajin nëntor 2017, duke shënuar rritje prej rreth 18,778 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 1.5 për qind.

Në muajin nëntor 2017, sistemi bankar rezulton me rritje prej 2,611 milionë lekë ose +0.2 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.




## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin nëntor 2017 arriti në rreth 553,954 milionë lekë. Balanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 676,6 milionë lekë, ose rritje prej rreth 0.12 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 50.7 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 280,998 milionë lekë.

Gjatë muajit nëntor 2017, zëri “Korporata jo-financiare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 61.1 për qind ose 338,532 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 31.91 për qind ose 176,781 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 5.34 dhe 1.50 për qind apo 29,560 dhe 8,285 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin nëntor 2017, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 50.0 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 39.3 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 71.8 për qind dhe rreth 24.6 për qind.


Fig-9



**Rritja e stokut total të kredive**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-10




**Përberja e kredive Nëntor '17**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 255,070 milionë lekë në fund të muajit nëntor 2017. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në nëntor 2017 ka shënuar rënie mujore prej 0.01 për qind si dhe rritje vjetore prej 1.17 për qind, duke arritur nivelin 20.4 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rënie mujore prej 0.01 për qind dhe rritje vjetore prej 1.82 për qind, duke shënuar nivelin 25.6 për qind.

Fig-11




Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin nëntor 2017, kanë pësuar rënie prej 7,293 milionë lekë në krahasim me muajin nëntor 2016. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 82.9 për qind të tyre. Ndërsa depozitat në valutë gjatë muajit nëntor 2017 shënuan rritje prej 7,824 milionë lekë, mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 81.6 për qind të depozitave në valutë.

Fig-12



Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit nëntor 2017, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 82.9 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 12.1 për qind dhe nga “Korporata të tjera financiare” me 2.4 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 81.6 për qind dhe rreth 16.3 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 82.2 për qind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 819,891 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (143,094 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (18,181 milionë lekë) dhe “Korporata jofinanciare publike” (14,754 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1,576 milionë lekë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit nëntor 2017, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 997,499 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 2,176 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 530.0 milionë lekë.




Fig-13

**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë




Fig-14

**Përberja e depozitave Nëntor 2017**

Burimi: Banka e Shqipërisë


# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-nëntor 2017 janë mbledhur rreth 390.4 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 400.9 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 343.1 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 51.3 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 62% janë financime të brendshme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 266.2 miliardë lekë (ose rreth 99% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushtetit vendor rreth 17.2 miliardë lekë (ose rreth 95% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 78.2 miliardë lekë (ose rreth 100% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 19.2 miliardë lekë (ose rreth 92% e planit të periudhës janar-nëntor 2017).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 343.1 miliardë lekë, 66.2 miliardë lekë (19% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 29.6 miliardë lekë (9%) për shpenzime interesi, 35.9 miliardë lekë (10%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje,



1.5 miliardë lekë (0.5%) për subvencione, 140.6 miliardë lekë (41%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 45.1 miliardë lekë (13%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 19.8 miliardë lekë (6%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 88% (shpenzime personeli), 78% (shpenzime për interesat), 80% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 67% (subvencione), 90% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 97% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 85% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 66%, ndërsa financimi i huaj është 78% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-nëntor 2017 ishin rreth 390.4 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 362.8 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 19.2 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë periudhës Janar-Nëntor 2017 (mld Lekë) Revenues during January-November 2017 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Nëntor '17 November '17	Nëntor '16 November '16	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	125.9	119.1	4.8
	Taksa doganore (Custom Tax)	5.9	5.5	7.2
	Akcizat (Excise)	41.4	38.0	8.9
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	27.6	26.1	5.5
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	29.5	29.0	1.5
	Taksat nacionale (National Tax)	33.7	29.8	12.8

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Nëntor – 2017

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: November – 2017

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 10.5 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Nëntor 2017, u mbështet në vlerën 29.1 miliardë lekë nga financime të jashtme.

Për muajin Nëntor 2017, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 34.069 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 41.096 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin nëntor 2017, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 31.4 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 33.4 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 4.8 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Në përqindje	2013	2014	2015	2016	2017												In percent
	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November						
<b>Norma e depozitave</b>																	Deposits rates
12-M	4.17	1.51	1.27	0.78	0.69	0.94	0.90	0.81	0.75	0.77	0.69	0.56	0.74	0.81	0.74	0.74	12-M
6-M	3.40	1.16	1.17	0.78	0.57	0.78	0.58	0.53	0.72	0.80	0.49	0.81	0.69	0.54	0.61	0.61	6-M
3-M	2.72	0.83	0.54	0.27	0.31	0.27	0.28	0.25	0.27	0.28	0.24	0.26	0.34	0.30	0.26	0.26	3-M
1-M	2.79	1.47	0.88	0.87	0.86	0.68	0.97	0.97	1.01	0.96	0.92	0.75	0.68	0.77	0.87	0.87	1-M
<b>Norma e huasë</b>																	Lending rates
12-M	9.52	7.00	7.47	4.54	6.27	6.87	6.71	3.89	5.51	6.36	7.06	6.02	6.51	6.65	6.00	6.00	12-M
6-M	9.59	8.18	8.35	7.01	9.74	8.60	8.44	6.55	7.56	10.55	8.22	9.24	6.52	7.39	7.73	7.73	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>																	Securities rates
Bono thesari 1/																	Treasury bills 1/
3-M	3.40	3.15	-	-	1.22	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3-M
6-M	3.54	3.16	2.46	2.00	2.25	2.01	1.70	1.52	1.54	-	1.54	1.65	-	1.82	2.04	2.04	6-M
12-M	3.66	3.33	2.40	2.92	3.20	2.93	2.25	1.79	1.98	2.04	2.12	2.20	2.31	2.46	2.54	2.54	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 2** Kursi i këmbimit  
Exchange rate

Monedha	2013	2014	2015	2016	2017												Currency
					Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor		
					January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November		
<i>Mesatarja e periudhës</i>																	<i>Average of period</i>
USD	105.67	113.64	126.64	128.29	128.40	127.43	126.74	126.33	121.83	118.59	115.24	112.23	112.10	113.74	114.01	114.01	USD
EURO	140.27	140.11	137.65	135.27	136.57	135.59	135.38	135.42	134.58	133.21	132.57	132.53	133.55	133.66	133.49	133.49	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>																	<i>In the end of period</i>
USD	101.86	115.23	125.79	128.17	127.37	127.45	127.34	123.55	119.99	116.30	113.39	112.29	113.37	114.71	112.97	112.97	USD
EURO	140.20	140.14	137.28	135.23	136.39	135.08	136.13	135.03	134.19	132.59	132.98	133.50	133.70	133.42	113.64	113.64	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

	2013	2014	2015	2016	2017												In percent
	Në përqindje				Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor		
					January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November		
<b>Norma e depozitave</b>																Deposits rates	
12-M	4.17	1.51	1.27	0.78	0.69	0.94	0.90	0.81	0.75	0.77	0.69	0.56	0.74	0.81	0.74	12-M	
6-M	3.40	1.16	1.17	0.78	0.57	0.78	0.58	0.53	0.72	0.80	0.49	0.81	0.69	0.54	0.61	6-M	
3-M	2.72	0.83	0.54	0.27	0.31	0.27	0.28	0.25	0.27	0.28	0.24	0.26	0.34	0.30	0.26	3-M	
1-M	2.79	1.47	0.88	0.87	0.86	0.68	0.97	0.97	1.01	0.96	0.92	0.75	0.68	0.77	0.87	1-M	
<b>Norma e huasë</b>																Lending rates	
12-M	9.52	7.00	7.47	4.54	6.27	6.87	6.71	3.89	5.51	6.36	7.06	6.02	6.51	6.65	6.00	12-M	
6-M	9.59	8.18	8.35	7.01	9.74	8.60	8.44	6.55	7.56	10.55	8.22	9.24	6.52	7.39	7.73	6-M	
<b>Norma e letrave me vlerë</b>																Securities rates	
Bono thesari 1/																Treasury bills 1/	
3-M	3.40	3.15	-	-	1.22	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3-M	
6-M	3.54	3.16	2.46	2.00	2.25	2.01	1.70	1.52	1.54	-	1.54	1.65	-	1.82	2.04	6-M	
12-M	3.66	3.33	2.40	2.92	3.20	2.93	2.25	1.79	1.98	2.04	2.12	2.20	2.31	2.46	2.54	12-M	

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

## TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2017

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2017

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>32,893</b>	<b>64,046</b>	<b>101,554</b>	<b>140,290</b>	<b>176,744</b>	<b>212,290</b>	<b>248,616</b>	<b>284,884</b>	<b>320,072</b>	<b>356,376</b>	<b>390,445</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>186</b>	<b>644</b>	<b>1,415</b>	<b>1,933</b>	<b>2,777</b>	<b>3,592</b>	<b>4,087</b>	<b>5,051</b>	<b>5,607</b>	<b>7,096</b>	<b>8,384</b>	<b>Grants</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>30,935</b>	<b>59,660</b>	<b>94,551</b>	<b>129,856</b>	<b>163,439</b>	<b>196,233</b>	<b>230,811</b>	<b>264,780</b>	<b>298,043</b>	<b>331,393</b>	<b>362,858</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>22,022</b>	<b>42,806</b>	<b>69,995</b>	<b>93,352</b>	<b>118,725</b>	<b>143,261</b>	<b>168,349</b>	<b>193,770</b>	<b>218,608</b>	<b>242,485</b>	<b>266,241</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,146	20,237	31,302	41,918	53,745	65,757	78,284	89,798	101,921	114,448	125,953	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,620	3,827	11,177	13,447	15,326	17,399	19,291	21,069	23,465	25,336	27,631	Profit Tax
3	Akcizat	2,727	5,730	9,242	12,928	16,779	21,165	25,337	30,194	33,921	37,447	41,433	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,185	5,414	7,663	10,373	12,914	15,605	18,581	21,992	24,528	27,016	29,504	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,930	6,734	9,252	12,845	17,485	20,300	23,206	26,450	29,999	32,908	35,820	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	414	864	1,359	1,841	2,476	3,035	3,650	4,267	4,774	5,330	5,900	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>907</b>	<b>2,398</b>	<b>3,866</b>	<b>7,869</b>	<b>9,342</b>	<b>10,928</b>	<b>12,083</b>	<b>13,733</b>	<b>15,355</b>	<b>16,271</b>	<b>17,220</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	195	410	774	2,133	2,536	3,026	3,345	3,676	4,010	4,265	4,534	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	2	8	31	204	220	234	246	251	262	272	283	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	710	1,980	3,061	5,532	6,586	7,668	8,492	9,806	11,083	11,734	12,403	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>8,006</b>	<b>14,456</b>	<b>20,690</b>	<b>28,635</b>	<b>35,372</b>	<b>42,044</b>	<b>50,379</b>	<b>57,277</b>	<b>64,080</b>	<b>72,637</b>	<b>79,397</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	6,743	12,238	17,537	24,221	29,946	35,656	42,723	48,675	54,518	61,768	67,589	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,146	1,970	2,780	3,922	4,779	5,651	6,847	7,718	8,596	9,809	10,690	Health insurance
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>1,772</b>	<b>3,742</b>	<b>5,588</b>	<b>8,501</b>	<b>10,528</b>	<b>12,458</b>	<b>13,718</b>	<b>15,053</b>	<b>16,422</b>	<b>17,887</b>	<b>19,203</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë				908	908	908	908	908	908	908	908	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,320	2,901	4,108	5,222	6,794	8,272	9,221	10,060	10,969	11,875	12,795	Income of budgetary institutions
	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>25,636</b>	<b>55,790</b>	<b>95,188</b>	<b>129,824</b>	<b>170,446</b>	<b>209,595</b>	<b>247,391</b>	<b>284,983</b>	<b>322,603</b>	<b>359,881</b>	<b>400,977</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>24,640</b>	<b>52,729</b>	<b>84,833</b>	<b>114,223</b>	<b>147,096</b>	<b>180,897</b>	<b>214,109</b>	<b>246,850</b>	<b>277,626</b>	<b>309,651</b>	<b>343,125</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personeli</b>	<b>5,476</b>	<b>10,992</b>	<b>16,585</b>	<b>22,606</b>	<b>28,716</b>	<b>34,981</b>	<b>41,341</b>	<b>47,619</b>	<b>53,831</b>	<b>60,041</b>	<b>66,228</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	4,700	9,451	14,257	19,446	24,696	30,106	35,601	41,022	46,364	51,729	57,051	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	776	1,541	2,328	3,160	4,020	4,875	5,740	6,597	7,467	8,312	9,177	Social insurance contributions
I.2	<b>Interesat</b>	<b>2,830</b>	<b>5,570</b>	<b>7,823</b>	<b>9,795</b>	<b>12,144</b>	<b>14,289</b>	<b>17,007</b>	<b>19,613</b>	<b>21,612</b>	<b>24,121</b>	<b>29,621</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	2,078	4,190	5,909	7,291	9,142	10,731	12,706	14,681	16,323	18,110	19,679	Domestic
2	Të Huaja	752	1,380	1,914	2,504	3,002	3,558	4,301	4,932	5,289	6,011	9,942	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>1,567</b>	<b>4,503</b>	<b>8,630</b>	<b>11,105</b>	<b>14,580</b>	<b>18,273</b>	<b>21,916</b>	<b>24,680</b>	<b>27,886</b>	<b>32,037</b>	<b>35,959</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subveclonet</b>	<b>55</b>	<b>108</b>	<b>242</b>	<b>340</b>	<b>634</b>	<b>845</b>	<b>997</b>	<b>1,147</b>	<b>1,294</b>	<b>1,448</b>	<b>1,572</b>	<b>Subsidies</b>
I.5	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>11,892</b>	<b>23,845</b>	<b>37,429</b>	<b>50,126</b>	<b>63,259</b>	<b>77,522</b>	<b>91,269</b>	<b>105,660</b>	<b>118,973</b>	<b>132,175</b>	<b>144,665</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	8,645	17,397	27,010	36,420	46,160	56,190	66,121	76,929	86,903	96,776	105,988	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,640	5,319	8,284	11,063	14,063	18,290	21,438	25,020	28,096	31,425	34,703	Health insurance
I.6	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>1,789</b>	<b>4,855</b>	<b>8,914</b>	<b>13,269</b>	<b>18,818</b>	<b>23,946</b>	<b>28,727</b>	<b>33,508</b>	<b>37,796</b>	<b>41,691</b>	<b>45,193</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.7	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>1,031</b>	<b>2,856</b>	<b>5,210</b>	<b>6,982</b>	<b>8,945</b>	<b>11,041</b>	<b>12,852</b>	<b>14,623</b>	<b>16,234</b>	<b>18,138</b>	<b>19,887</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	41	74	108	140	168	195	220	244	271	295	319	Unemployment insurance benefits
II	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>												<b>Reserve fund/contingency</b>
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,254</b>	<b>3,127</b>	<b>10,300</b>	<b>15,224</b>	<b>22,266</b>	<b>26,846</b>	<b>30,796</b>	<b>35,126</b>	<b>41,336</b>	<b>46,510</b>	<b>51,366</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	118	1,246	7,086	10,898	14,169	16,601	18,714	21,028	25,103	28,801	31,636	Domestically financed
2	Financimi Huaj	1,136	1,881	3,214	4,326	8,097	9,951	11,709	13,694	15,817	17,264	19,254	Foreign financed
IV	<b>Detyrimet e prapambetuara</b>												<b>Arrears</b>
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>7,257</b>	<b>8,256</b>	<b>6,366</b>	<b>10,466</b>	<b>6,298</b>	<b>2,695</b>	<b>1,225</b>	<b>-99</b>	<b>-2,531</b>	<b>-3,505</b>	<b>-10,532</b>	<b>CASH BALANCE</b>
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-7,257</b>	<b>-8,256</b>	<b>-6,366</b>	<b>-10,466</b>	<b>-6,298</b>	<b>-2,695</b>	<b>-1,225</b>	<b>99</b>	<b>2,531</b>	<b>3,505</b>	<b>10,532</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-7,785</b>	<b>-18,552</b>	<b>-15,516</b>	<b>-15,343</b>	<b>-13,026</b>	<b>-9,120</b>	<b>-7,728</b>	<b>-7,274</b>	<b>-14,675</b>	<b>-23,164</b>	<b>-18,591</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	4	24	123	283	284	347	355	366	372	402	410	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	7,474	8,681	11,187	11,815	13,517	14,238	13,022	12,750	13,740	16,135	16,204	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-15,263	-27,257	-26,826	-27,441	-26,827	-23,705	-21,105	-20,390	-28,787	-39,701	-35,205	Others
V.3	<b>I huaj</b>	<b>528</b>	<b>10,296</b>	<b>9,150</b>	<b>4,877</b>	<b>6,728</b>	<b>6,425</b>	<b>6,503</b>	<b>7,373</b>	<b>17,206</b>	<b>26,669</b>	<b>29,123</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,473	2,185	2,924	5,667	9,456	10,950	13,335	14,877	16,678	18,097	20,729	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nën-hua	391	768	1,128	1,937	2,697	3,628	4,548	5,427	6,129	6,485	7,005	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-312	-144	41	-1,298	-1,399	-923	-1,065	-701	-234	-134	588	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-811	-1,793	-3,863	-9,540	-11,377	-13,650	-16,525	-17,561	-18,771	-22,114	-23,500	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	178	10,048	10,048	10,048	10,048	10,048	10,758	10,758	19,533	30,820	31,306	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

\*Chang. of stat. Account\* stands for the change in Foreign Financing Deposit

\* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

## Tabela e investimeve 2017

Table of investments 2017

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million ALL)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>118</b>	<b>1,246</b>	<b>7,086</b>	<b>10,898</b>	<b>14,169</b>	<b>16,601</b>	<b>18,714</b>	<b>21,028</b>	<b>25,103</b>	<b>28,801</b>	<b>31,636</b>	<b>Domestic financing</b>
Në %	9.41	39.85	68.80	71.58	63.64	62.52	61.51	60.56	61.35	62.52	62.17	In %
<b>Financim i huaj</b>	<b>1,136</b>	<b>1,881</b>	<b>3,214</b>	<b>4,326</b>	<b>8,097</b>	<b>9,951</b>	<b>11,709</b>	<b>13,694</b>	<b>15,817</b>	<b>17,264</b>	<b>19,254</b>	<b>Foreign financing</b>
Në %	90.59	60.15	31.20	28.42	36.36	37.48	38.49	39.44	38.65	37.48	37.83	In %
<b>Totali</b>	<b>1,254</b>	<b>3,127</b>	<b>10,300</b>	<b>15,224</b>	<b>22,266</b>	<b>26,552</b>	<b>30,423</b>	<b>34,722</b>	<b>40,920</b>	<b>46,065</b>	<b>50,890</b>	<b>Total</b>
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2017**  
**CUSTOMS REVENUES 2017**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million Lek)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November	
Taksë doganore	414	864	1,359	1,841	2,476	3,035	3,649	4,267	4,774	5,330	5,900	Customs Duties
TVSH	5,775	13,085	22,069	30,209	39,025	48,259	57,617	66,868	75,597	85,135	94,191	V.A.T
Akcizë	2,727	5,730	9,242	12,928	16,779	21,165	25,337	30,194	33,921	37,447	41,433	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	250	438	585	937	1,078	1,216	1,374	1,541	1,738	1,909	2,112	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>9,166</b>	<b>20,117</b>	<b>33,255</b>	<b>45,915</b>	<b>59,358</b>	<b>73,675</b>	<b>87,977</b>	<b>102,870</b>	<b>116,030</b>	<b>129,821</b>	<b>143,636</b>	<b>Total</b>

**TË ARDHURAT TATIMORE 2017 (TAX REVENUE )**

TVSH	4,370	7,151	9,233	11,709	14,720	17,498	20,667	22,930	26,324	29,312	31,762	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,620	3,827	11,177	13,447	15,326	17,399	19,292	21,069	23,465	25,336	27,631	Profit Tax
